

MICROCEM Bardh/Gri

ÇIMENTO E PAPERSHKUESHME OSMOTIKE

Karakteristika

MICROCEM Bardh/Gri është një parapërzierje pluhuri e gatshme për përdorim, për t'u përzier vetëm me ujë e përbërë, nga lidhje çimentoje me qëndrueshmëri të veçantë, shtesa specifike kimike dhe lëndë inerte të thërmuara, të përzgjedhura. Me t'u kryer përzierja kemi një përzierje të hollë çimentoje, e cila e përdorur me brushë në shtresë të hollë e të vazhdueshme, është në gjendje të krijojë një papershkueshmëri ndaj shtytjes, edhe negative, të ujit.

Kjo vjen nga kapja optimale e kësaj përzierje të hollë me sipërfaqe mbështetëse si dhe nga ngopja e kapilarëve dhe e mikrodëmtimeve të strukturës falë veprimeve të reagenteve kimik që janë të pranishëm te ky produkt, të cilët absorbohen si rezultat i osmozës në rrjetëzën kapilare, ku kombinohen me gëlqeret e hidratuara.

Fusha e përdorimit

MICROCEM Bardh/Gri përdoret për të siguruar papershkueshmërinë e lokaleve nëntokë, bodrumeve, hapësirave të ashensorit, depozitave për mbajtjen e ujit (vaska, tubacione, serbatorë, pishina etj) me shtytje uji në pjerrësi ose jo.

Avantazhe

- Jo organike
- Qëndron në kohë
- E papershkueshme nga avulli i ujit
- Papershkueshmëri e dyfishtë stukturore dhe sipërfaqësore

Sipërfaqe të përshtatshme

- beton i ri e i vjetër
- suva me çimento

Mënyra përdorimi

Përgatitje e sipërfaqeve

Sipërfaqet e caktuara duhen të jenë të shëndetshme, pa pluhur, vajëra e yndyrëra, pa pjesë të degraduara apo që janë duke u shqitur. Këshillohet larja me hedhje uji. Parregullsitë e mundshme (largësues, zona zhavorri, pjesë të prishura) duhen rregulluar më parë/riparuar me solucione të linjës PRO, tipi PROMALT ose PRORIP.

Hekurat e armaturës duhen trajtuar që më parë me FERMALT Në këndet horizontale dhe vertikale mbush me allçi në formë trekëndore për të rakorduar me pareteT për të paktën 10 cm duke përdorur Ilaçe të përforcuara me fibër me qëndrueshmëri të lartë mekanike të tipit PROMALT e PRORIP.

Të gjitha veprimet e restaurimit duhen të bëhen të paktën 24 orë para aplikimit të çimentos së hollë.

Lage mirë sipërfaqen e caktuar para përdorimit të produktit.

Përgatitja e Ilaçit (solucionit)

Përziej përmbajtjen e një thesi 25 kg me 6.25 – 6.75 l ujë të pastër me anë të një traçonë me nunër të ulët rrotullimesh (300-400 rrot/min) e me shufër për 2-3 min derisa të arrihet një përzierje me dendësinë e nevojshme për përdorim.

Në rast përdorimi mbi sipërfaqe tepër të lëmuara ose si dorë e parë, përdor një litër MICROLAT në vend të një litri ujë për përzjerje.

Përdorim

Pas përzjerjes, prit rreth 10 minuta, ripërziej e pastaj apliko MICROCEM BIANCO - dy duar tërthorazi në interval 6-8 orë nga njëra-tjetra duke përdorur një penel të hollë ose një brushë me fibra prej gjethes së agaves.

Kur të jetë menduar t'i hidhet dora e suvasë, të mbushet me një solucion çimento të përzier me MICROLAT.

Përzjerja e hollë e çimentos MICROCEM BARDH/GRI nuk mund të aplikohet mbi sipërfaqe të lagështa e me prurje uji. Prandaj të bllokohet qysh më parë çdo hyrje e mundshme uji me MICROBLOC.

Të dhëna teknike dhe aplikuese

| | |
|---|--|
| - Pamja | pluhur ngjyrë të bardhë/gri |
| - Peshë specifike e llaçit të freskët | rreth 1.950 kg/m ³ |
| - Ambalazhimi | thes 25 kg |
| - Konsumi i mesëm/20mm trashësi | 1.5 – 1.6 kg/m ² |
| - Uji i përzjerjes | 25 – 27 % |
| - Qëndrueshmëria në përkulje (28 ditë) | 3.5 N/mm ² |
| - Qëndrueshmëria në shtypje (28 ditë) | 22 N/mm ² |
| - Koha e zgjatjes së përzjerjes (20° C) | rreth 40 min |
| - Diametri max inert | 0.6 mm |
| - Koha e përzjerjes | 2-3 min |
| - Trashësia max e nevojshme | 2 mm |
| - Temperatura e përdorimit | +5 / +35° C |
| - Koha e ruajtjes | 12 muaj nëse mbahet në vend të thatë e të freskët në ambalazhin origjinal të vulosur |

Qëndrueshmëri mekanike: Qëndrueshmëritë mekanike, të pasqyruara në tabelë, janë nxjerrë nga mostra 4 x 4 x 16 cm, të ambalazuara në laborator me 26 % ujë dhe të maturuara në 20°C dhe U.R. 90%. Të dhënat mund të ndryshojnë ndërkohë që ndryshojnë kushtet e përzjerjes e të staxhionimit.

Vërej: Vlera të tilla u referohen provave laboratorike në lagështi dhe temperatura konstante. Po këto mund të ndryshojnë në varësi të kushteve termoigrometrike të kantierit.

Paralajmërime

- ** Shmang prurjet e ujit 24 orët e para pas aplikimit
- ** Mos e përdor mbi sipërfaqe të ngrira ose që mund të ngrihen gjatë 24 orëve të ardhshme
- ** Mos e përdor mbi sipërfaqe tepër të nxehta, ku fryn erë e fortë apo në pishë të diellit
- ** Mos i shtoj ujë produktit të përzier
- ** Mos e përdor mbi sipërfaqe allçie
- ** Këshillohet që sipërfaqja të mbahet e lagur 2 ditë pas aplikimit
- ** Në rast papërshtueshmërie të brendshme të vaskave ose serbatorëve, atëherë mbushja me ujë mund të bëhet vetëm me maturimin e Microcem bardh/gri të papërshtueshëm dhe jo më parë se 3 javë nga aplikimi.
- ** Strukturat prej betoni duhen të përshtaten me shtytjen e ujit.